



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 25.05.2023

Nr: 144

Ora: 14:50

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 82, DATË 23.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA KOALICIONI "BASHKË FITOJMË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 25.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Koalicioni "Bashkë Fitojmë", përfaqësuar nga z. Franci Nuri

PALË E INTERESUAR: "Partia Socialiste e Shqipërisë", përfaqësuar nga z. Eridian Salianji

OBJEKT:

- Kundërshtim i vendimit nr. 292, datë 18.05.2023 të KZAZ nr. 20, bashkia Krujë, qarku Durrës "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Krujë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023".
- Kundërshtim i vendimit nr. 293, datë 18.05.2023 të KZAZ nr. 20, bashkia Krujë, qarku Durrës "Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse



të Rezultateve për zgjedhjen e këshillit të bashkisë Krujë, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023”.

3. Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në ato QV të zonës zgjedhore bashkia Krujë, ku janë përfshirë komisionerë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të Kodit Zgjedhor.

4. Rregullimin e pasojave duke proceduar me ndryshimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit përkatës, duke mospërfshirë rezultatin e qendrave të votimit objekt ankimi.

BAZË LIGJORE:

Nenet 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 82 regj., datë 23.05.2023.

Në mbledhjen e datës 25.05.2023, pas relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 82 i plotësonte elementet e formës të parashikuara në nenin 126 dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Gjatë seancës paraprake, subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Eridian Salianji depozitoi kërkesën nr.5484 prot., datë 25.05.2023, për të marrë pjesë si palë e interesuar në seancën e shqyrtimit të kërkesës ankimore. Kjo kërkesë u pranua nga KAS.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 82, datë 23.05.2023, të paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 26.05.2023, ora 10:30.
3. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Elvis	ÇEFA	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar